



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 3 par. 1 pika b, të Rregullores nr. 2007/30 për ndryshimin e Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës dhe të nenit 16, par.1, pika **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2008 merr

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E PROJEKTIT IDEOR TË RRUGËS
“UNAZA E BRENDSHME” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin e projektit ideor të rrugës “Unaza e brendshme” në Prishtinë, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-13926, të dt. 14.6.2005.

Neni 2

Ndryshimi i projektit, nga neni 1 i këtij Vendimi, ka të bëjë me pjesën e trasesë të planifikuar me projektin ideor të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-13926, të dt. 14.6.2005.

Ndryshimi i pjesës së trasesë, nga par. 1 i këtij neni, përfshinë stacionazhën +0.00 km deri te stacionazha + 8.00 km të projektit ideor të kësaj rruge unazore në tërësi, sipas situacionit grafik të pjesës së ndryshuar të kësaj trajektoreje, i cili paraqet pjesë përbërëse të projektit ideor dhe të këtij Vendimi.

Neni 3

Hartimi i projektit zbatues të rrugës “Unaza e brendshme”, do të bëhet sipas projektit ideor të miratuar me Vendimin nr. 01-031-13926, të dt. 14.6.2005, ndërsa për stacionazhat e përshkruara në par. 2 të nenit 2, do të bëhet sipas këtij Vendimi. Ky Vendim do të shërbejë edhe si bazë juridike për shpalljen me interes të përgjithshëm të tokës së nevojshme për realizim të projektit zbatues për këtë pjesë të rrugës unazore.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Prishtinës. Secila drejtori e Komunës së Prishtinës do të kryejë veprime nga përgjegjësia e caktuar me Statut dhe rregullativën tjetër ligjore, me qëllim të realizimit të këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 344-624, më 21.5.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Mustafa